



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIK OF
KOSOVO GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË
VUSHTRRI / OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U VUČITRNU
MUNICIPAL MINOR OF FENCES COURT IN VUSHTRRI



03-3888/12
30.10.2012

Nr.regj. 7789/2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE VUSHTRRI, gjyqtari duke e vendosur ne procedurën kundërvajtëse kundër të pandehures Bahrije Pllana nga Shtitarica, për kundërvajtje nga neni 17 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurise te zyrtareve te larte publik, dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtar, e në bazë të nenit 73,74,195, dhe 199 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me datën 23.10.2012 bjen kete:

A K T V E N D I M

E PANDEHURA: Bahrije Halim Pllana e lindur me dt. 06.02.1965 në Vushtrri tani banon ne Shtitarice komuna, inxhinjere, e martuar, te kryer fakultetin teknik, gjendjen ekonomike mesatare, me pare jo e denuar.

E S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S

Sepse e pandehura Bahrije Pllana zyrtar i larte publik ne komunen e Vushtrris, e cila ka qene e obliguar qe ta beje deklarimin e pasurise deri me datën 31.03.2012 per vitin paraprak, dhe ta njoftoj Agjencionin kunder korrupsionit, mirepo e njejta nuk e ka permbushur obligimin ligjor te parapar me ligjin per deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e pasurise.

me cka ka bërë kundërvajtje mos deklarimi i pasurise nga 17 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurise te zyrtareve te larte public, dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtar.

dhe konforme nenit 9 te LMK-es:

D E N O H E T

Me gjobë në shum prej 500 / pesqinde/ € të cilin gjobë e pandehura ka për të pague në afatin prej 15 ditësh pasi që ky aktvendim të merr formën e prerë në favor të KGJK, nëse gjobën e shqiptuar nuk e pagan në afatin prej 15 ditësh e njejta konformë nenit 5 të LMK-ës do t'i zavendsohet me denim burgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh duke llogaritur nga 15 € për një ditë burge.

Konformë nenit 109 al. 2 të LMK-ës e pandehura është e obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5 € në afat të njejt me gjobën.

Nga një kopje të këtij aktvendimi të iu dërgohet të pandehures dhe parashtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kunder Korrupsionit Prishtine ka parashtruar kërkesën nr. 01-2544/12 dt. 01.08.2012 për iniciimin e procedures kundërvajtëse ndaj të pandehures Bahrije Pllana nga Shtitarica, për kundërvajtje, neni 17 paragrafi 1 pika 1.1 Ligjit te cekur me larte.

Gjyqtari e inicioi procedurën për kundërvajtje duke e marrë në pyetje te pandehuren me c' rast e njejta kundervajtjen me te cilen e ngarkon kerkesa e Agjencise Kunder Korrupsion Prishtine e pranon por e njejta ne mbrojtjen e sajë shton: eshte e vertet se permes internetit na kane ardhe formularet te cilet kemi qene te obliguara ti mbushim dhe te dhanat e kerkuara ti japim ne afatin ligjor mirepo une nuk kam arrite qe brenda keti afati ti plotesoi formularet por kete e kam bere me vone me daten 13.04.2012 dhe kete vonese e kam bere per shkak se nje vajze te vogel e kam pas te smut dhe kam qene e angazhuar rreth sajë kurse per dergimin e te dhanave Agjencionit te cekur e deshmoi me vertetimin te cilen e kam prezentue ne gjykate.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, marrjes në pyetje të pandehures, gjyqtari në mënyrë të plotë dhe të drejtë e vërtetoi gjendjen faktike se e pandehura nuk e ka bere me kohe deklarimin e pasurise por lme nje vonese te vogel, tremedhjete dite pas afatit, e me kete ka kryer kundërvajtje me te cilen ngarkohet, per cka të njejtrn e shpalli përgjegjës dhe konforme me nenin 9 te LMK-es si rrethane lehtesuese e muarr faktin se e njejta e ka bere deklarimin e pasurise pas afatit ligjor ashtuqe te njejtës ja zbuti denimin dhe per kundervajtjen e kryer e denoi me gjobën e cekur si në dispozitiv të këti aktvendimi.

Me rastin e shqiptimit të denimit gjyqari i vlersoi të gjitha rrethanat nga neni 7 të LMK-s dhe të pandehures ja shqiptoi këtë denim duke llogarit se edhe me këtë denim do të arrihet efekti i denimit ndaj të pandehures që e njejta në të ardhmen të mos kryej kundërvajtje të këtilla apo të ngjajshme.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv.

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE VUSHARRIJE

dt. 23.10.2012



KSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi ankesë mund të parashtrohet e pandehura dhe ushtruesi i kërkesës në afatin prej 8 ditësh pas marrjes së këtij aktvendimi. ankesa parashtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.